



Prishtinë: 24 qershor 2008

Kodi i ZRRE: D_085_2008

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, duke u bazuar në:

1. Nenin 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Nenin 24.3 të Kushteve të Përgjithshme për Furnizim me Energji;
3. Nenin 7.1 të Kodit të Matjes;
4. Kërkesën e Korporatës Energjetike të Kosovës Sh.A.(tani e tutje KEK) për miratimin e Procedurave për Matje dhe Faturim të Energjisë të Konsumuar në Hapësira të Përbashkëta.

Në seancën e mbajtur më 24 qershor 2008 nxjerrë këtë:

VENDIM

I. Miratohen Procedurat për Matje dhe Faturim të Energjisë të Konsumuar në Hapësira të Përbashkëta

1. Në mars 2008 KEK-u ka ushtruar kërkesën për miratimin e Procedurave për Matje dhe Faturim të Energjisë të Konsumuar në Hapësira të Përbashkëta;
2. Pas vlerësimit të kërkesës dhe shqyrtimit dhe plotësimit të dokumenteve të bashkangjitura, ZRRE ka vendosur të miratojë dokumentet si në dispozitiv të këtij vendimi si të përkohshme deri në nxjerrjen e atyre të qëndrueshme të një kohëzgjatje më të madhe me veprim nga 1 prilli 2009;
3. Pas marrjes së njoftimit nga ZRRE-ja apo publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, KEK do t'i publikojë në faqen e vet elektronike Procedurat e miratuara;
4. Ky Vendim nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht. Në rast të mospërputhjes midis versioneve të ndryshme, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe;
5. Palët e pakënaqura mund të paraqesin ankesë kundër këtij vendimi në gjykatën e juridiksionit përkatës, brenda 14 ditësh nga data e miratimit ose datës së publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së;
6. Ky vendim hyn në fuqi me datën e miratimit nga ana e Bordit të ZRRE-së.



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

Bashkangjitur: Versioni i miratuar:

Procedurat për Matje dhe Faturim të Energjisë të Konsumuar në Hapësira të Përbashkëta

Bordi i ZRRE-së:

Ali Hamiti, Kryesues

Theranda Beqiri, Anëtare

Nysret Avdiu, Anëtar